



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËTOR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020

Qëllimi i revizionit:

Nëse raporti financiar është i liru nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- zbatimi joadekuatë i dispozitave ligjore me të cilat rregullohet e drejta e rrogës dhe
- nuk është kryer në tërësi regjistrimi i mjeteve, kërkesave dhe obligimeve në pajtim me procedurat e paraparë të akteve ligjore dhe nënligjore.

Mendimi i dhënë/përfundim *:

Shprehëm mendim me rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare, si dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimeve dhe politikave të vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- Pagesa e rrogave të kryet në pajtim me rregullat ligjore, gjatë së cilës rroga bazë kryesisht të caktohet në bazë të kërkesave të vendit të punës;
- Të realizohen në tërësi procedurat e regjistrimit në pajtim me aktet ligjore.

Dobësitë kyçe të sistemit:

- Harmonizimi dhe saktësia plotësuese e rregullativës ligjore në bazë të procedurës për punësimet, mënyrën e punësimeve dhe statusi i të punësuarve në Agjenci;
- Nevoja e aktvendimit ligjor për përdorimin e mjeteve financiare nga ndarja M.F – Funksionet e shtetit si plan financiar për plotësimin e detyrimeve ligjore të lidhura me proceset zgjedhore.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Është marrë njoftimi pas Draft-Raportit të revizorit të autorizuar shtetëror, me të cilën Agjencia ka njoftuar se nuk ka vërejtje të Draft-Raportit i dorëzuar, si dhe ka informuar për fillimin e aktiviteteve në pajtim me rekomandimet e dhënë në raport.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Përgjigjja e njoftimit është dhënë në shtojcën e Raportit Përfundimtar.

*  pozitive,  me rezervë  të pavolitshëm  të përmbajtur